



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe nenit 2 të Marrëveshjes për Bashkëfinancim 1-400-65335 të datës 23.10.2018 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale të mbeturinave "Pastrimi" sh.a Prishtinë, , Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **25,155 €** (njëzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë euro),konform Marrëveshjes për Bashkëfinancim 1-400-65335 të datës 23.10.2018 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale të mbeturinave "Pastrimi" sh.a Prishtinë, qëllimi i së cilës është blerja dhe distribiumi i 3000 (tre mijë) shportave për mbeturina në shërbim të qytetarëve të Komunës.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, kategoria ekonomike – fondi për bashkëfinancim me donator në xhironlogarinë bankare të Kompanisë Rajonale të mbeturinave "Pastrimi" nr. 1700-2001-0005-1292 në NLB Banka.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë .

1Nr. 400-48345
Lipjan, më 05.10.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

